V E N D I M
Nr.57, datë 2.2.2001

PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË AFATMESME DHE TË PLANIT TË VEPRIMIT, PËR ZHVILLIMIN E NDËRMARRJEVE TË VOGLA DHE TË MESME

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të vendimit nr.422, datë 5.11.1999, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, "Për miratimin e përbërjes dhe të programit politik të Këshillit të Ministrave", me propozimin e Ministrit të Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Miratimin e strategjisë afatmesme dhe të planit të veprimit, për zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta